

Njoftim për përqendrim me anë të së cilit Ndërmarrja për telekomunikacion Telekom Srbija Shoqëri Aksionare, Beograd, Republika e Serbisë do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi SHOQËRINË PËR TELEKOMUNIKIME KABLLORE NEXT FIBER (NEXT FIBER) SHPK NOVI PAZAR, Republika e Serbisë

(lënda nr. 08-25 / 2026)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 26.01.2026 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me anë të së cilit Ndërmarrja për telekomunikacion “Telekom Srbija” shoqëri aksionare, Beograd, me seli të regjistruar në rrugën “Takovska” numër 2, Beograd, Republika e Serbisë, do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi kapitalin themelor të SHOQËRISË PËR TELEKOMUNIKIME KABLLORE NEXT FIBER (NEXT FIBER) SHPK NOVI PAZAR me seli të regjistruar në rrugën SAVE KOVAÇEVIQA 296, 36300 Novi Pazar, Republika e Serbisë.

-Ndërmarrja për telekomunikacion Telekom Srbija shoqëri aksionare, Beograd, është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike, i regjistruar për telekomunikime kablllore, ndërsa nga shërbimet që ofron veçojmë shërbimet për telefoninë fikse dhe celulare, internet dhe shërbime multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

Ndërmarrja për telekomunikacion Telekom Srbija shoqëri aksionare, **Beograd** ka shoqëri të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut:

-Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, selia e së cilës është regjistruar në rrugën “Maksim Gorki” 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë e telekomunikimeve me tela, përkatësisht për ofrimin e shërbimeve vijuese: rrjet publik për radio-komunikim, qasje në internet me brez të gjerë (broadband), shërbime ndër-operatorësh, shërbime telefonike të qasshme për publikun në rrjetin publik të komunikimit celular, ritransmetim i shërbimeve programore televizive, satelit.

Person i lidhur i Shoqërisë për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup është **Shoqëria për telekomunikacion MTELMOBILE SHPKNJP Shkup**. Shoqëria për telekomunikacion MTELMOBILE SHPKNJP Shkup punon në tregun për ofrimin e shërbimeve celulare të komunikimit elektronik (shërbimi me parapagesë/prepaid) dhe nuk u ofron përdoruesve të saj përfundimtar shërbim celular postpaid *Shoqëria për telekomunikacion MTELMOBILE SHPKNJP Shkup* është operator i rrjetit virtual celular (ORRVC) në tregun maqedonas për komunikime elektronike dhe ofron shërbime zanore, SMS dhe internet kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming.

Gjithashtu, person i lidhur i Ndërmarrjes për telekomunikacion Telekom Srbija shoqëri aksionare, Beograd në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është: Shoqëria për tregti dhe shërbime **TOTAL TV SHPK Shkup** (“TOTAL TV SHPK Shkup”), me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 17, 1-001/Shkup – Qendër, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtari – telekomunikime satelitore.

-SHOQËRIA PËR TELEKOMUNIKIME KABLLORE NEXT FIBER (NEXT FIBER) SHPK NOVI PAZAR është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike,

në momentin e dorëzimit të njoftimit, i regjistruar për ofrimin e qasjes në internet dhe shërbime interneti, shpërndarje të përmbajtjes mediatike, telefoni fikse.

-SHOQËRIA PËR TELEKOMUNIKIME KABLLORE NEXT FIBER (NEXT FIBER) SHPK NOVI PAZAR nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe as nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

Tregjet të cilave u referohet përqendrimi:

Parashtruesi i njoftimit propozon që si treg përkatës në përqendrimin në fjalë të jetë tregu i pakicës për ofrimin e shërbimeve të qasjes fikse në internet me brez të gjerë, tregu i pakicës për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike, tregu i pakicës për ofrimin e shërbimeve për telefoni fikse.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni u bën thirrje palëve të treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të mbërrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga dita e shpalljes së këtij njoftimi.

27.01.2026

Shkup